VENDIM
Nr. 697, datë 5.10.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1269, DATË 17.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE DETYRAT E PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHTETËRORE, TË NGARKUARA PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1269, datë 17.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimi "... Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit...", zëvendësohet me emërtimin "… Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ...".

2. Pika 2, e shkronjës "B", të kreut III, ndryshon me këtë përmbajtje:

"2. Kryen vlerësimin ligjor të krijimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, të plotësuara nga kryetarët e bashkive, për familjet bujqësore ose individët, në rastet e kërkesave të paraqitura nga qytetarët apo institucionet shtetërore, në territoret e:

a) ish-kooperativave bujqësore, në zbatim të pikës 1/1, të nenit 17, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar;

b) ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zbatim të ligjit nr. 57/2012, "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore", dhe të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar.

Komisioni vendor vlerëson aktet e marrjes së tokës në pronësi, të plotësuara nga kryetarët e bashkive, për bazueshmërinë ligjore të tyre dhe merr vendim për rikonfirmimin e tyre, në rastet kur:

a) vërtetohet se familja bujqësore ose individi, në emër të të cilit lëshohet akti i marrjes së tokës në pronësi, është subjekt i përfitimit të tokës bujqësore në pronësi, sipas ligjeve të sipër-përmendur;

b) verifikohet se sipërfaqja, për të cilën është lëshuar akti i marrjes së tokës në pronësi, është objekt i trajtimit sipas ligjeve të sipërpërmendur dhe madhësia e saj është në përputhje me përcaktimet ligjore;

c) janë krijuar në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në ligjet e sipërpërmendur.".

3. Pika 4, e shkronjës "B", të kreut III, ndryshon me këtë përmbajtje:

"4. Dërgon për regjistrim në ZVRPP vendimin gjyqësor përfundimtar për sipërfaqet e tokës të liruara nga fitimi, mbajtja dhe përdorimi i paligjshëm i tyre, që kalojnë në pronësi të shtetit, pas procedurave të realizuara sipas përcaktimeve të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar. Pjesë e detyrueshme e këtij vendimi është planvendosja e ngastrës/ave.

Për këto sipërfaqe toke KV-ja harton, së bashku me DAMT-in, pranë Këshillit të Qarkut, procesverbalin përkatës, në përmbajtje të të cilit pasqyrohen vendndodhja (fshati dhe bashkia, zona kadastrale), numri dhe lloji kadastral i ngastrës, sipas regjistrit të DAMT-it, sipas sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe sipërfaqja e saj, i shoqëruar me planvendosjen e ngastrës/ave. Përgjegjësi i DAMT-it, pas marrjes së kopjes së procesverbalit dhe në mbështetje të tij, njofton për këtë veprim edhe bashkinë, në territorin e së cilës ndodhet toka.

Komisioni vendor, një kopje të vendimit gjyqësor përfundimtar, të planvendosjes së ngastrës/ave dhe procesverbalit, për ngastrat që ndodhen në territorin e ish-ndërmarrjeve bujqësore, i paraqet në Agjencinë e Trajtimit të Pronës. Këto sipërfaqe të tokës përdoren për fondin e kompensimit fizik, në zbatim të ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave".

Përgjegjësi i DAMT-it, pas marrjes së kopjes së procesverbalit dhe në mbështetje të tij, për ngastrat që ndodhen në territorin e ish-kooperativave bujqësore, e paraqet atë në bashkinë, në territorin e së cilës ndodhet toka, për t'u administruar sipas dispozitave të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998, "Për tokat bujqësore të pandara".

Komisionet vendore kanë detyrimin që, brenda dy muajve, nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, të paraqesin në Agjencinë e Trajtimit të Pronës të gjitha vendimet gjyqësore përfundimtare, të marra para kësaj date, të shoqëruara me planvendosjet e ngastrës/ave dhe procesverbalin/et përkatës.".

4. Pika 2, e kreut IV, ndryshon me këtë përmbajtje:

"2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme që, për çdo vit, të planifikojë, në buxhetin vjetor të institucionit të prefektit të qarkut, si zë të veçantë, një fond për mbulimin e shpenzimeve të KV-së, sipas propozimeve të komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë prefekturave dhe të paraqitura nga sekretariati teknik pranë KQT-së.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama